



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Korrik 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Korrik 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin korrik të vitit 2023)**

Përfaqësues të sistemit prokurorial morën pjesë në punëtorinë e Grupit koordinues dhe grupeve punuese për reformën në drejtësi

Në kuadër zbatimit të Deklaratës së Përbashkët të Zotimit është mbajtur punëtorja e Grupit koordinues për reformën në drejtësi dhe grupeve punuese, në të cilën morën pjesë përfaqësues të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Ministrisë së Drejtësisë (MD), përfaqësues ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile.



Qëllimi i mbajtjes së kësaj punëtorie ishte prezantimi i raporteve të gjashtë grupeve punuese me gjetje dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe disiplinës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, fuqizimin e mekanizmave të brendshëm për verifikim dhe kontroll të integritetit, avancimin dhe fuqizimin e statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe forcimin e mekanizmave për deklarim të pasurisë për gjyqtarë dhe prokurorë.

Gjithashtu në fokus ishte edhe trajtimi i rrjedhës së implementimit të obligimeve që dalin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimit, të cilën e kanë nënshkruar Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Supreme.

Me këtë rast, Kryesuesi Jetish Maloku, theksoi përkushtimin e KPK-së për bashkëpunimin ndërinstitucional gjatë zbatimit të reformës në sektorin e drejtësisë në Kosovë, në mënyrë që të realizohen me sukses aktivitetet e parapara në këtë proces të rëndësishëm.

Mbahet punëtori për trajtimin e zbatimit të SMIL-it, çështjeve të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga z.Veton Shabani, në bashkëpunim dhe me mbështetje nga Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST), është duke mbajtur një punëtori dyditore, në të cilën po marrin pjesë përfaqësues të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale, prokurorive themelore, Sekretariatit të KPK-së, EUKOJUST-it dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë.



Që në hapje të punëtorisë, Kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, z. Veton Shabani, theksoi se një ndër synimet kryesore është që të ketë zbatim të plotë të SMIL-it, digjitalizim të administratës, largim të regjistrave fizikë, shkëmbim elektronik të të dhënave ndërinstitucionale dhe gjenerim të raporteve statistikore në kohë reale, duke thënë se KPK-ja është duke punuar intensivisht, përmes trupave të vet, për zbatimin e këtyre objektivave të përcaktuara.

Në vijim të punëtorisë është bërë prezantimi i raporteve për zbatimin e SMIL-it nga ana e përfaqësuesve të Sekretariatit të KPK-së, ZKPSH-së dhe prokurorive të të gjitha niveleve, si dhe do të diskutohet edhe për çështjet e infrastrukturës së objekteve dhe sigurisë së tyre, si dhe për burimet njerëzore të sistemit prokurorial të Kosovës.

Me këtë rast, nga diskutimet e zhvilluara gjatë kësaj punëtorie do të identifikohen mënyrat e tejkalimit të sfidave që kanë të bëjnë me funksionalizimin dhe

mbarëvajtjen e zbatimit të SMIL-it dhe aktiviteteteve të administratës, me qëllim të avancimit të shërbimeve të nevojshme në sistemin prokurorial të Kosovës.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së, i udhëhequr nga z.Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni dhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-së.



Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i draftit të Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2018 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit, në përputhje me Ligjin e ri për Prokurorin e Shtetit, i cili përcakton që prokurorët me mandat fillestarë do të ngarkohen me lëndë edhe gjatë periudhës së paraparë për trajnim në Akademinë e Drejtësisë së Kosovës.

Me këtë rast, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative kanë dhënë komentet e tyre dhe vendosën që këtë çështje ta inkorporojnë në draftin e Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit.

Gjithashtu, ky Komision ka vendosur që ky udhëzim me këto plotësime dhe ndryshime të dalë në dëgjim publik në uebfaqen e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit të për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga z. Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarë të KPK-së, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z.Besim Kelmendi, Zëvendëskryesuesi i KPK-së, z.Veton Shabani,

përfaqësuesja e Ambasadës së SHBA-së dhe shoqërisë civile.



Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i komenteve lidhur me draftin e Rregullores për Shtesat dhe Kompensimet për Prokurorët e Shtetit dhe të Punësuarit e Sistemit Prokurorial, i cili është draftuar pas miratimit të Ligjit për Paga në Sektorin Publik, ligj ky, i cili ka dhënë të drejtën që të përcaktohet mënyra dhe procedura e kompensimit dhe shtesave për prokurorët e shtetit dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial të Kosovës.

Pas prezantimit para pjesëmarrësve të këtij drafti nën nga ana e Komisionit për Çështje Normative janë prezantuar edhe komentet e përfaqësuesve të shoqërisë civile, konkretisht të Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe ekspertëve të tjerë, të marra gjatë dëgjimit publik dhe një pjesë e tyre që kanë pasur relevancë janë inkorporuar në tekstin e përgjithshëm.

Në fund të takimit u theksua se pas shqyrtimit të serishëm të kësaj draftrregulloreje në takimin e radhës së Komisionit, i njëjti do të procedohet për miratim në njërin nga takimet e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës reagon ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për miratimin e Projektligjit të ri për KPK-në

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) reagon ndaj vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit të ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur dje, më 12 korrik 2022, duke e cilësuar si tentativë të re për të cenuar pavarësinë e saj.

Gjithashtu, KPK-ja, më këtë rast, thekson se miratimi i Ligjit të ri për KPK-në është vazhdim i procesit të njëanshëm të Qeverisë së Kosovës, i cili njëkohësisht minon bashkëpunimin tonë për procesin e reformës, të shprehur përmes nënshkrimit të Deklaratës së

Përbashkët të Zotimit nga institucionet tona relevante të drejtësisë.



Këshilli Prokurorial, deklaron se përkundrajt asaj që Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pas kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së tij, Qeveria e Kosovës nuk është mjaftuar me verdiktin e organit më të lartë kushtetues në vend dhe ka vazhduar me moskordinimin e plotë dhe ka miratuar me nxitim dhe në mënyrë të njëanshme këtë Projektligj tejet të rëndësishëm, pa përfillur fare Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe procesin e reformës në drejtësi dhe duke injoruar plotësisht bashkërendimin e nevojshëm me sistemin prokurorial dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

KPK-ja, deklaron me bindje se sistemi prokurorial ka përkrahur reformën e filluar, përfshirë ndryshimet ligjore për të cilat është shprehur vullneti i angazhimit të përbashkët, porse kjo nismë ligjore është dashur të realizohet në kohën e duhur, andaj çdo rikthim i iniciativave dhe i vendimeve të këtij lloji, pa respektuar ndarjen e pushteteve dhe pa koordinimin e ndërsjellë, siç ka ndodhur në të kaluarën dhe siç po ndodhë edhe tani nga ana e Qeverisë së Kosovës, është kthim i madh prapa dhe sjellë dështim, andaj KPK-ja paralajmëron se do të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe kushtetuese për ta kontestuar përmbajtjen e Ligjit të ri të KPK-së, pasi që i njëjti cenon mandatin kushtetues dhe pavarësinë e sistemit prokurorial, si dhe anashkalon standardet ndërkombëtare, duke pamundësuar funksionalizimin e tij dhe duke e bërë atë lehtësisht të ndikuar nga politika.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, deklaron se mbetet i përkushtuar për të mbështetur proceset e përgjithshme reformuese dhe angazhohet që së bashku me të gjithë partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, të bashkëveprojë në çdo lloj nisme që ka për qëllim reformimin e nevojshëm, në mënyrë që të fuqizohet sundimi i ligjit në Kosovë dhe sistemi prokurorial i Kosovës të bëjë punën e vet të pavarur, profesionale, transparente.

Këshilli Prokurorial i Kosovës reagon ndaj gjuhës së përdorur nga avokati Berisha ndaj prokurorit Maloku

Këshilli Prokurorial i Kosovës shpreh keqardhje për nivelin e gjuhës së përdorur nga avokati Besnik Berisha ndaj prokurorit të shtetit, Rasim Maloku, në një intervistë të dhënë mbrëmë në emisionin “Ditari i Buzhalës”.

KPK-ja, thekson me këtë rast se, përdorimi i një gjuhe të tillë kundër prokurorit të shtetit është në kundërshtim me misionin dhe rolin që ka Prokurori i Shtetit, kur dihet saktë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet nuk lejojnë veprime kundër vlerave që i kërkon sundimi i ligjit.



Këshilli Prokurorial i Kosovës kundërshton deklaratimet e tilla ndaj punës së secilit prokuror dhe në këtë aspekt siguron se do të përkrahë çdo angazhim dhe aktivitet që përkon me arritjen e parametrave të një pune sa më efektive deri në ndriçimin e plotë dhe në zgjidhjen e rasteve të ndryshme, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi.

Andaj, KPK-ja, vlerëson se, kjo nuk do të arrijë të zbehë punën e prokurorëve, por është një motiv drejt realizimit të plotë të misionit të tyre institucional, bazuar mbi standardet e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale dhe në praktikat ndërkombëtare, të zbatueshme në Kosovë.

KPK-ja, si pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë në vendin tonë, pret që të punohet intensivisht për ndriçimin deri në fund edhe të këtij rasti, duke vënë në pah përfundimisht dhe me konsekuencë se pavarësia e sistemit prokurorial është thelbësore dhe e rëndësishme në rrugën sfiduese që kemi përpara.